



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E ORAHOVECI - OPŠTINA ORAHOVAČ
Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
Odejenje za Urbanizam, Planiranje i Zašt. Sredine

Prilozak 358 MB
-XII- Br. 26.12.2023
ORAHOVEC - ORAHOVAČ



PLANI VJETORË I PUNËS 2024

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Përmbajtja

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	2
SEKTORI I URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT	2
SEKTORI I MJEDISIT	4
Sistemi i Adresave	4
Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal 2023-2031	4
Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit 2023-2027	4
Plani Lokal i Veprimit për Biodiversitet 2023-2027	5
Ndërtimi i Sheshit Qëndor në Qytet.....	5
Shënimi i Ditës së Tokës	5
Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit.....	5
Ecuria e realizimit të projekteve kapitale.....	6

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave duke u bazuar në obligimet që dalin nga Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligji Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr.06/L-024 për trajtimin e Ndërtimeve pa Leje dhe Statuti të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017. Raport në bazë të punëve të cilat janë realizuar gjatë vitit 2022 nga Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Në kuadër të Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit funksionojnë dy sektorë,

- Sektori i Urbanizmit dhe Planifikimit,
- Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit

Të hyrat buxhetore në DUPMM (gjashtë mujorin e parë) për vitet 2022-2023

Viti	2023
Të hyra Janar- Dhjetor	66,284.61

Kërkesat për gjashtë mujorin e parë për vitet 2022-2023

Janar- Qershor	2023
Leje Ndërtimore	70
Leje Mjedisore	29
Kushte Ndërtimore	113

SEKTORI I URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT

Në vitin 2022 zyrtarët e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit nga sektori për Urbanizëm dhe Planifikim janë angazhuar në lehtësimin e procedurave për aplikimin e lejeve të ndërtimit, kërkesave të qytetarëve, investitorëve. Në aspektin e planifikimit hapësinor dhe urban brenda afatit ligjor janë trajtuar kërkesat, janë dhënë kushtet e ndërtimit dhe lejet e ndërtimit për objektet të cilat janë në harmoni me planet urbanistike që janë të miratuara në Kuvendin e Komunës, sipas Planit Zhvillimor Komunal në fuqi. Për marrjen e kushteve ndërtimore dhe lejes së ndërtimit janë dorëzuar së bashku me dokumentacionet e nevojshme edhe projektet ideore dhe projektet zbatuese të cilat janë pranuar nga zyrtarët përgjegjës, me ç' rast është bërë kontrollimi i tyre. Po ashtu janë dhënë edhe pëlqime. Me vendim të kryetarit të datës 15.09.2022 janë emëruar dy zyrtar përgjegjës për mbikëqyrjen e kërkesave për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe kushtet e ndërtimit.

Në sektorin e Urbanizmit dhe Planifikimit janë shqyrtuar:

	Janar – Qershor 2023				
Kërkesat	Nr	Ap	Re	Sh	Hudhet
Leje ndertimi	72	56	1	13	2
Leje rrenimi	9	8		1	
Leje perdorimi	5	4		1	
Kushte nderimore	119	87	8	9	15
Shkrese	52	52			
Pelqim ndrimdestinim	89	76	6	2	4 hudhet 1 cedohet
Ankesa	1			1	
Referenca	1	1			
Vertetim	2	2			
Legalizim	4	4			
Gjithësejt	354	290	15	27	22

Të hyrat e përgjithëshme Janar - Qershor –2023

Parallogaria	55,392.78 €
Leje perdorimi	80 €
Leje rrenimi	30 €
Vendim	30 €
Vertetim –Pelqim	2,305 €
Legalizim	1,972.52 €
Totali i të hyrave	59,810.3 €

SEKTORI I MJEDISIT

Në baze të Sektorit të mjedisit leshojm Leje mjedisore Komunale dhe Leje Ujore Komunale.

Janar - Qershor 2023					
Kërkesat	Nr	Ap	Re	Sh	Hudhet
Leje Mjedisore	32	27	3	2	

Të hyrat e përgjithëshme në Sektorin e Mjedisit Janar -Mars –2023

Leje Mjedisore	7089.57
----------------	---------

Sistemi i Adresave

Në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bashkpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, është angazhuar Stafin Mbështetës për rrjedhat e procesit të Kompletimit të Sistemit të Adresave, detyrë e zyrtarit të angazhuar është harmonizimin emrave të rrugëve në ARIS, ndryshimin e formave të rrugëve (ndarje/bashkim kodesh), kontrollën e hyrjeve sipas metodologjisë së caktuar dhe përgatitjen në statusin “gati për aprovim” për t’i paraqitur në Gjeoportali dhe shfrytëzim nga qytetarët dhe institucionet.

Në gjashtë muajin e parë janë mbledhur të dhëna për këto vendbanime: Fortesë, Celin, Krushë e Madhe, Hoçë e Vogël, Brestoc, Nagavc, Nashpall, Zoqisht, Hoçë e Madhe, Optrushë, Retijë, Retijë e Poshtme, Bërnjak, Pataqan i Epërm, Pataqan i Ulët, Sapniq, Xërxe, Gexhë, Malësi e Vogël, Bratotin, Vrajakë, Ratkoc, Dejnë, Çifllak, Kramovik, Gur i Kuq, Mrasor, Dobidol, Nashpall, Kaznik dhe Pastasell.

Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal 2023-2031

Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031, është një dokument multisektorial i cili përcakton kahet e zhvillimit të komunës për 8 vitet e ardhshme. Plani Zhvillimor Komunal është miratuar në Kuvedin Komunal.

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit 2023-2027

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit 2023-2027 për Komunën e Rahovecit, si dokument planifikues - strategjik, që adreson zgjidhjen e problemeve në sektorin e ajrit në nivel lokal.

Ky plan ka për qëllim kryesor që të definojë veprimet për menaxhimin e cilësisë së ajrit përbrenda territorit të komunës së Rahovecit për periudhën pesë vjeçare.

Plani Lokal i Veprimit për Biodiversitet 2023-2027

Plani Lokal i Veprimit për Biodiversitet 2024-2028 për Komunën e Rahovecit, si dokument planifikues - strategjik, që adreson zgjidhjen e problemeve në sektorin e biodiversitetit në nivel lokal.

Ky plan ka për qëllim kryesor përmirësimin e gjendjes së biodiversitetit në territorin e komunës. Në kuadër të planit është bërë vlerësimi i gjendjes ekzistuese, janë identifikuar problemet kryesore, janë përcaktuar prioritetet kryesore si dhe janë planifikuar afatet, veprimet, aktivitetet dhe projektet kryesore që do të ndërmerren për periudhën e ardhshme 5 vjeçare për natyrën dhe biodiversitetin e Rahovecit.

Ndërtimi i Sheshit Qëndror në Qytet

Sheshi Qëndror është projekt më i madhë që është realizuar ndonjëher në Komunën e Rahovecit.

Përmes këtij projekti, synojmë që të kemi qasje në hapësira publike të sigurta, të shëndetshme dhe për të gjithë qytetarët, e në veçanti për fëmijët, të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta.

Gjithashtu, synohet edhe krijimi i mundësive të reja për biznes dhe rritja e cilësisë së jetës urbane.

Pasë vonesave të shkaktuara nga zhvendosjes dhe ndërrimin e gypit të vjetër ekzistues Ø250 azbest çimento me atë të ri Ø250 polietilen.

Punimet janë duke vazhduar me pregaditjen e bazamentit të parkingut nëntokësor, ku deri në muajin shtator planifikohet të përfundoj parking nëntokësorë.

Shënimi i Ditës së Tokës

Me moton 22.04.2023 u shënu Ditës së Tokës me disa aktivitete: Mbjellja e luleve në qytetun e Rahovecit dhe në fshatra, pastrimi vullnetar i rrugëve, pastrimi i mjedisit përreth objekteve shkollore, pastrimi i varrezave të dëshmorve, eliminimi i deponive ilegale.

Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit

Në bashkpunim me asociacionin Pamkos, është organizuar aksioni i pastrimit "Drini rrjedhë i lirë pa plastik"

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Objekti i Banimit Social, ky objektë është drejtë përfundimit deri në fundë të muajit qershor do përfundonjë punimet.
- Rregullimi i shtratit të përroit në lagjen e Kelmendve në Kramovik, ky project ka përfunduar.
- Vazhdimi i rregullimit dhe ristrukturimi Lumit Rimnik në Fortesë, kanë filluar punimet me ndërtimin e kolektorit të ujrave të zeza.
- Ndërtimi i parqeve në Komunën e Rahovecit, ku përfshihen ndërtimi i parqeve në fshatrat: Kramovik, Guri i Kuq, Brestoc, Xërxë, Pataqan i Epërm, Çifllak, Drenoc, Krushë e Madhe, Ratkoc. Parku në Ratkoc ka përfunduar, Krushë e Madhe, Pataqan i Epërm, Çifllak, Gur i Kuq dhe Brestoc janë drejtë përfundimit.
- Sheshi Republika gjatë këtijë muji operatori do rikthetë në punime për përmbylljen e projektit.
- Rregullimi i shtratit të përroit në Krushë të Madhe, është bërë pastrami i shtratit deri në Drin të Bardh.
- Rregullimi i shtratit të përroit në Malësi të Vogël ka vazdhur ndërtimi i pjesës së mbetur.
- Rregullimi i shtratit të përroit në Polluzhë, planifikohet të filloj në fund të muajit korrik.
- Mbjellja dhe mirëmbajtja e lueleve, janë rregulluar hapësira publike.